

Edlira Përfundi mban pozicioni si Drejtor I Drejtorisë së Politikave për Trashëgiminë Kulturore në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, që nga janari i vitit 2024.

Diplomuar në vitin 2007 në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, ku ka marrë një diplomë në Financë dhe Kontabilitet me profil financiar.

Në janar 2022 deri në 2024, ka mbajtur pozita të tjera të rëndësishme, duke filluar me rolin e Drejtoreshës së Shërbimit të Trupit Diplomatik në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjatë kësaj periudhe, ajo ka qenë kryetare e Këshillit Drejtues dhe ka pasur përgjegjësinë e organizimit dhe administrimit të të gjithë sektoreve të institucionit, si dhe përfaqësimin e tij në marrëdhëniet juridike dhe administrative.

Në 2021 ka pasur një rol të rëndësishëm në Departamentin Rregullator & Përputhshmërinë pranë Kryeministrit, si dhe si Drejtoreshë e Ndërmarrjes Industriale nr.1 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Më herët, Edlira ka punuar si përgjegjëse e zyrës së arkës dhe protokollit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku ka menaxhuar arkën dhe protokollin.

Ajo ka filluar karrierën e saj si kontabiliste, duke punuar për dy kompani të ndryshme, ku ka qenë përgjegjëse për kontrollin e sistemit të kontabilitetit, regjistrimin e veprimeve kontabël dhe raportimet përkatëse në institucionet tatimore.

Përveç përvojës së saj të pasur, Edlira është e njohur për aftësitë e saj në menaxhimin e projekteve dhe koordinimin e aktiviteteve me institucione të ndryshme, si dhe për angazhimin e saj në zhvillimin e politikave për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.